



PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 7 (shtatë) të rregullt për vitin 2026, të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	24.06.2026
Ora:	10:00

Prezentë në takim:

Znj. Sanie Kuçi
Rexhepaj

Z. Flamur Bytyçi

Znj. Doruntina Zenelaj

Z. Urim Suka

Z. Astrit Salihu

Z. Nexhat Ramadani

Znj. Vlorë Kryeziu

Znj. Dafina Kolgeci

Z. Bexhet Kuçi

Znj. Albulena Kokollari

Z. Edon Sadikaj

Z. Aziz Bytyçi

Znj. Mimoza Bajraktari

Z. Enver Shabani

Znj. Besa Kuçi

Z. Syl Zenelaj

Z. Ilir Voci

Z. Dardan Berisha

Z. Labinot Halitjaha

Znj. Merita Basha

Z. Demokrat Vataj

Znj. Afërdita Morina

Znj. Antigona Zyba

Z. Liridon Fandaj

Z. Qëndrim Elshani

Znj. Laureta Tafaj

Znj. Jehona Rrafshi

Lumi

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës

Media dhe qytetarë

OSCE, LMT, KDI

Znj. Habibe Bytyqi

Z. Xheladin Sad

Takimin e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z.Bexhet Kuçi,i cili i njoftoi me rendin e ditës.

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për komunën e Suharekës;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen interes i përgjithshëm publik pronat private;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e vlerës së bonus banimit;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit dhe dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;
7. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Suharekës për vitin 2025;
8. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga zyra kombëtare e auditimit;
9. Pyetje dhe përgjigje;

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për komunën e Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - fillimisht s’e di pse nuk po ndodh kjo praktika e prezantimit të pikës nga drejtori por ndoshta edhe sot po mungon drejtori në një dokument kaq të rëndësishëm.Në këtë rast shpreh një keqardhje se si një ndër dokumentet më të rëndësishme të komunës është përgaditur në këtë formë dhe kaq joprofesional.Në praktikën e mëhershme edhe pse ato kanë qenë të këqija,të paktën një dokument i një rëndësie të tillë i ka pas disa rrugë se si ka ardhë deri te ne për me diskutu këtu.Një prej tyre ka qenë dëgjimet publike që në një formë edhe tash ka ndodh por edhe ka qenë një praktikë ku DSHPE i ka dërgu një formular kryetarëve të fshatrave dhe pastaj kryetarët e fshatrave në bashkëpunim me këshillat e fshatrave i kanë vendos prioritetet e tyre për vendbanimet e tyre dhe i kanë sjell në komunë,edhe pse shpeshëherë këto propozime nuk janë përfill por të paktën e kanë pas mundësinë me i sjell propozimet në kuadër të këshillit.Shpreh një keqardhje të madhe se pse kjo nuk ka ndodh për me përgadit këtë dokument tani.Unë me disa kryetar të fshatrave kam komunikuar dhe ata më kanë thënë që për këtë vit nuk kanë marrë një formular për me përgadit dokumentin.Unë kam biseduar me këta kryetar të fshatrave edhe në kuadër të dëgjimeve publike dhe shumica nga dëgjimet publike që ju i keni mbajtur,për fatin e keq ato propozime që kanë dal aty nuk reflektojnë edhe në këtë kornizë që e kemi sot para vetes.Ne sot jemi në vitin 2026 dhe ende ka shumë probleme në secilin vendbanim me kanalizim,kanë mungesë të ujit. Kryetari ka shku,i ka taku fermerët dhe i ka thënë që kemi me i bërë subvencionet për qumështin 5 cent por nuk ia ka dhënë as 3 centëshin për vitin 2025.Kryetar është mirë ose me ia dhënë paret fermerëve për qumështin ose me dal këtu dhe me ju kërkua falje.Kjo kornizë nuk po reflekton që edhe për tri vitet e ardhshme kanë me u zgjidh këto probleme dhe kjo më shqetëson.Unë kur e mora materialin e krahasova me buxhetin në janar që ju e keni miratu dhe për fatin e keq është një përsëritje e keqe.Në shumicën e rasteve janë projektet e njejtat,edhe ato me gabime drejtshkrimore.P.sh. te Drejtoria e Urbanizmit të gjitha projektet që kanë qenë në buxhetin që është miratuar në vitin që jemi tash, prap në këtë kornizë janë të njejtat,p.sh. Ndërtimi i zonave infrastrukturore smart; Fasadimi i objekteve kolektive-ndërtesat e ballkanit Suharekë; Ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugëve urbane në

Suharekë.Drejtoria e Bujqësis- Projekte me bashkëfinancim: Ndërtimi i sistemit të ujitjes në Studenqan dhe kjo ka katër vite që është i njëjti projekt. Asfaltimi i rrugëve në bjeshkët e Vraniqit-faza e tretë; Ndërtimi i infrastruktures rrugore për bujqësi dhe pylltari. Te Drejtoria e Arsimit komplet projektet janë të njëjta. E di që shkollën në Njëpërbisht dhe palestrën në Peqan i kanë marrë përmbaruesit por prap rikonstruimi i shkollave: Sllapuzhan, Destan Bajraktari dhe Migjeni.Ndërtimi i qerdes në Bllacë; Ndërtimi i urave Reqan-Reshtan-Bukosh.

Kam disa shqetësime meqë edhe vet jam nga Bllaca dhe më vjen turp kur po i adresoj sepse i kam adresu në secilën kornizë,në secilin buxhet kur është miratu,i kam adresu në facebook,i kanë adresu edhe shumë qytetar dhe keni premtu që do ti zgjidhni dhe sot e kësaj dite nuk marrin zgjidhje.Probleme të theksuara me kanalizim në Bllacë dhe korniza nuk pe parasheh.Drejtori s'është sot por drejtori ka thënë që me më pas ngu mua,kisha nda shumë më shumë mjete për kanalizime sepse ka probleme të mëdhaja,por sot nuk ka reflektu ajo në buxhet.Një pjesë e fshatit nuk ka ujë.Mungesë e trotuarit që shkon për Malishevë;Ura dhe shtrati i lumit nuk ka rrethoja dhe është rrezik sepse fëmijët kalojnë andej.Rruga Xhemajl Zekolli ka qenë në planifikim të këtij viti dhe sipas informatave që kam,me paramasë tash nuk e keni fut këtë rrugë por nuk është as në planifikim në bazë të kësaj kornize.Unë e di që këshilli i fshatit me banorët e lagjes Zekolli i kanë bërë do pare,e kanë bërë një projekt kur e kanë pa që nuk po marrin mbështetje nga këtu.E kanë dërgu projektin në ministri dhe po presin.Por çka nëse edhe ata e refuzojnë? Dua të flas edhe për disa probleme në fshatin Duhël.Rruga Xhamia ka qenë në planifikim për këtë vit,tash me paramasë sipas banorëve është heq.Nuk figuron fare por në bazë të planifikimit që ju e keni sjell në këtë kornizë,nuk po figuron as për vitin 2027 por e keni fut për vitin 2028.Mungesa e ujit në Duhël.Burimi sipas banorëve ekziston në Duhël dhe veq duhet të bëhet grumbullimi atje dhe me shtri rrjetin.Duhet me pas vullnet me nda pare dhe me bo Duhlën me ujë.Unë e pash që këto ditë keni fillu me një kontratë me i bo disa sanime sepse ma ngat këtu dhe ma lehtë,edhe pse dikun kanë qenë më të kalueshme.Te rrethi në Duhël është një grope e madhe por edhe te hyrja e fshatit Bllacë dhe Duhël të cilën e kemi diskutu vazhdimisht dhe keni thënë që keni me zgjidh por ende s'po zgjidhet.Tash e keni kontratën dhe është mirë me i zgjidh edhe ato.Ajo që më çudit është edhe te premtimi që vet e keni pas për shkollën 7 Marsi. Të gjithë jemi dakord që shkolla 7 Marsi duhet me qenë e re por në planifikimet tuaja nuk figuron edhe për tri vitet e ardhshme.Ju lus që votën ta japim kundër sepse një papërgjegjësi të këtij pushteti për me miratu një buxhet që është dokumenti kryesor dhe që krijon perspektivën për tri vitet e ardhshme,ne e legjitimojmë nëse e qojmë dorën për.Prandaj vota kundër është vote për me dhënë një mundësi me e bë një planifikim më të mire dhe me i dhënë zhvillim pak më të mire kësaj komune,përndryshe qytetarët janë të braktisur nga kjo qeverisje komunale.

Kryetari - është e vërtetë që sot është korniza,një dokument shumë me rëndësi për neve dhe gjithë qytetarët e komunës së Suharekës.Ju e dini që ndahet në 5 kategori dhe kornizën ose tavanin e cakton tjetërkush.Te investimet kapitale duhet t'na kuptoni që vitin e kaluar prej buxhetit tone janë heq afërsisht 3.5 milion euro dhe këtë vit ka mrrri në 750 mijë euro.Rruga në Vraniq ka me qenë ndoshta edhe faza e katër,është rrugë e bjeshkës dhe është 5 kilomentra rrugë dhe nuk ka mundësi me 100 mijë euro të kryhet ajo rrugë.Urim,me fol është lehtë por me punu është shumë zor.Ato që janë parapa në buxhet nuk përsëriten por p.sh. vitin e kaluar kanë pas m'u nis urat.2 vjeqar ka qenë projekti në Reshtan dhe kanë me u bë dy ura,dhe është duke u punu ura.Nuk ka shancë një urë me u punu dy herë.Investimet kapitale nuk janë vetëm në rrugë por ka shkolla,ka qerdhe,ka fusha sportive,ka kanalizime.Ne e kemi një marrëveshje me hidroregjionin afërsisht 350 mijë euro për shtimin e sasisë së ujit dhe është duke u punu në Suharekë në lagjen e Peqanit.Tash ka me fillu një gyp i ri i ujësjellësit prej Suharekës deri në Peqan.Është e paraparë Sllapuzhani dhe janë të parapara me u hap pusët në Duhël.Sivjet fillon trotuari te shelqet duke shku teposht.Edhe vitin e kaluar kemi kryer kanalizime dhe kemi me kry kanalizime me këto mjete që i kemi.Sivjet është një kontratë tash që fillon,afërsisht 420 mijë euro.Ne në shumë vende edhe intervenojmë edhe pse ju e dini që në moment që i dorëzojmë kanalizimet aty ku ka ujë,taksën e merr hidroregjioni dhe e ka obligim me i mirëmbajtë ato.Përmende subvencionet e qumështit dhe është e vërtetë por i kanë marrë dhe nuk mund të kthehen ato.Janë dokumentet, kërkon.Dikun 2.500.00,00€ kanë marrë vetëm invetsime kapitale.Kanë marrë mallra dhe shërbime,kanë marrë subvencione,kanë marrë komunale.Kjo po ndodh në të gjitha komunat e RKS-së.Këtë vit kemi rritje të buxhetit për vitin e ardhshëm për 1% por të hyrat janë rrit rreth 600.000,00€.Buxheti është nda në bazë të numrit të banorëve.Janë të gjitha procesverbalet që janë mbajtë për çdo fshat dhe çka kemi pas mundësi me i fut në buxhet,i kemi fut.

Urim Suka - për Vraniq unë thash është përsëritje por sikur ta kishe shkruar te Vraniqi që është faza e katër, kisha kuptu që është vazhdim. Faza e tretë po shkruan në buxhetin e viti 2026 dhe faza e tretë shkruan për buxhetin e vitit 2027, e njëjta është. Është duke u punu ura në Reshtan. Askund nuk figuron në planifikim për me u bë urë në Reshtan. Tjetërkund ka qenë planifikimi dhe këta e kanë ndërru dhe është përsëritje prapë. Uji në Duhël the që është i paraparë. Qu trego ku e ke në kornizën buxhetore ujësjellësin në Duhël dhe nëse e ke unë të kërkoj falje. I përmende subvencionet dhe the që i kanë marrë. Ti ke shku i ke taku në fshat dhe i ke premtu 5 cent. Ka dështu projekti. Dil këtu dhe kërkoju falje. Nuk ja ke dhënë as 3 cent për vitin 2025 dhe kjo kornizë me sa unë po e shoh nuk garanton as për këtë vit dhe as për vitet e ardhshme që ke mi ia dhënë. E përmendi lagjen Boka që kanë investu, po është e vërtetë por rruga nuk është kryer ende krejt dhe nuk e ke në buxhet. Ju lus mos ta votojmë.

Qëndrim Elshani - sot para nesh kemi dokumentin më të rëndësishëm që përcakton fatin e zhvillimit të komunës sonë për tri vitet e ardhme mirëpo pas një analize të detajuar të tabelës 4.2 të KAB, ky draft-buxhet nuk është pasqyrë e zhvillimit por është një dokument i diferencimit territorial, fragmentimit elektorial dhe i humbjes së parasë publike. Unë dhe grupi jonë nuk mund ta mbështesim këtë planifikim për disa arsye. Njëra prej tyre është diskriminimi i vendbanimeve dhe shpërndarja pa asnjë kriter. Buxheti i komunës paguhet nga gjithë qytetarët e Suharekës në mënyrë të barabartë por nuk po kthehet te ta në mënyrë të barabartë. Ky planifikim nuk bazohet në numrin e popullsisë apo nevojat emergjente të fshatrave. Pse vendbanimet e mëdhaja, si Mushtisht, Studenqani,

Samadraxha apo Gjinoci lihen anash ose me projekte të coptuara, ndërsa shohim favorizime të pashpjegueshme në zonat tjera? Nuk mund të pranojmë që ndarja e investimeve të bëhet mbi baza të kalkulimeve partiake e elektorale duke i denu qytetarët e fshatrave të tëra vetëm pse nuk janë në hartën e interesit të ekzekutivit. Politika e asfaltit dhe kozmetikës. Asfalti nuk mundet me u shtru me dëshira apo me kalkulime inxhinierike. Në këtë listë ne shohim projekte rrugore ku ndahen nga 10.000,00€, 15.000,00€ apo 20.000,00€, e po ua rikujtoj disa shembuj nga dokumenti në Sallagrazhdë, në Savrovë, Mohlan, e Reqan ku kemi faza e segmente rrugësh me shuma minimaliste që nuk mjaftojnë as për zhavorr e leje më për asfaltime standarte. P.sh. te rrugët lokale në Peqan apo Popolan shihen alokime prej 5.000,00 deri 20.000,00€. Kjo është tallje me banorët. Me këto mjete nuk mund të përfundohet as një rrugë e vetme. Ky quhet coptim i qëllimshëm i buxhetit. Qëllimi është që t'u premtohet 5 apo 10 lagjeve nga pak, të hyhet në kontrata që mbetet deri në gjysëm puna dhe në fund kemi një rrugë pa trotuar, pa kanalizim që prishen ende pa i bërë 2 vjet. Tjetër është mungesa e transparencës dhe thasët e mëdhenjë me para. Ky ekzekutiv po kërkon nga ne si asambleist që ta nënshkruajmë blanko në shuma të mëdha pa na treguar se ku po shkon saktësisht secili cent. Te projektet komunale kemi projekte si: instalimi dhe sanimi i ndriçimeve publike në fshatrat Savrovë, Doberdelan, Bukosh, Sopijë në vlerë prej 800.000,00€. Pse janë bërë bashkë këto fshatra në një kod? Sa para shkojnë për Savrovën e sa për Doberdelanin? Ky grupim është bërë qëllimisht që drejtoria ti menaxhoj mjetet me vullnet politik gjatë vitit duke anashkaluar kontrollin e kësaj asambleje. Ne kërkojmë që çdo fshat ta ketë vijën e vet buxhetore dhe projektin e vet të ndarë. Tjetër është injorimi i prioriteteve jetësore, uji dhe kanalizimi. Deri sa qytetarët tanë në shumë fshatra përballën me mungesë të ujit të pijshëm dhe të rrjetit të kanalizimit, ky buxhet fokusohet në projekte kozmetike. Pse projektet e ujësjellësit dhe kanalizimet lihen në plan të dytë apo me shuma qesharake, ndërsa u jepet prioritet absolut për rrugica të pafundme lagjes që besa shpeshëherë qojnë në shtëpitë e zyrtarëve apo militantëve partiak. Të nderuar asambleist, ne jemi përzgjedhur nga populli për të mbrojtur interesin publik, jo për të qenë makineri votimi e dëshirave të Kryetarit të komunës. Andaj ne si grup propozojmë këto amandamente të cilat edhe e kushtëzojnë votën tone: 1. Rishikimi i menjëhershëm i projekteve nën 30.000,00€ 2. Të mos lejohet coptimi i rrugëve në faza të pafundme dhe projektet që nisen duhet të buxhetohen plotësisht dhe të përfundojnë brenda vitit fiskal; 3. Decentralizimi i kodeve të përbashkëta, pra projekti i ndriçimit prej 800.000,00€ dhe projektet e tjera të përbashkëta të ndahen saktësisht për secilin fshat sipas numrit të banorëve dhe duhet të ketë rritje të buxhetit për Studenqanin, Mushtishtin, Samadraxhën, Gjinocin dhe vendbanime tjera të mëdha duke marrë si kriter në bazë të numrit zyrtar të popullsisë dhe kërkesat në dëgjimet publike. Nëse ekzekutivi nuk reflekton

dhe nuk sjell një tabelë të shikuar ku respektohet qytetari i Suharekës dhe paraja publike, ne si grup parlamentar i LVV-së votojmë kundër këtij draft-buxheti.

Dafina Kolgeci - duke iu bashku parafolësve të cilët folën në pika të gjata për KAB, unë do të flas vetëm për sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenie sociale, konkretisht për projektin blerje dhe paisje me aparatura medicinale në QKMF. Nëse i shohim raportet paraprake, tash kemi një mospërputhje. Në planifikimin e mëparshëm vlera për këtë buxhet ka qenë 120.000,00€ dhe tash është 190.000,00€. Si

grup dhe personalisht e mbështesim çdo investim që bëhet në shëndetësi duke pas parasysh gjendjen që e kemi në shëndetësinë publike. Megjithatë këto ndryshime që po vijnë, vazhdimisht vijnë të pashoqëruara me një analizë ose arsyetim profesional apo financiar. Çka konkretisht mendoni me bo me këto 70.000,00€ shtesë? Nuk jemi kundër që të shtohet buxheti por mendoj që duhet me pas një arsyetim profesional financiar për secilin ndryshim që bëhet për me ditë se ku po shkojnë mjetet financiare të qytetarëve.

Flamur Bytyçi - kisha pas dëshirë me qenë Nënkryetarja këtu për shkak se ka qenë shumë e shqetësuar pse nëpër dëgjime publike nuk ka qytetarë aktiv. Ky dokument mua po ma dëshmon pse qytetarët nuk vijnë nëpër dëgjime publike. Po nisem nga dëgjimi publik që ka qenë në Semetisht. Në këtë pasqyrë afatmesme-buxhetore nuk janë përfshirë asnjëri prej propozimeve të banorëve të fshatit. Mos pritni me ardhë qytetarët nëpër dëgjime publike nëse ju nuk i respektoni kërkesat e tyre që i kanë. Te sistemi smart, më kujtohet mandatin e kaluar që Drejtori Enver e pat pranë që kjo smart and save city që ju e quani, ka dështu krejt dhe këtë ju kasha lut ta heqni prej kornizës sepse aty s'ka smart kurgja. Aty ka vetëm vija edhe drita. Andaj për mua korniza afatmesme buxhetore nuk duhet me u votu për shkak se asnjëra prej kërkesa të banorëve nuk janë të përfshira. Ata kanë kërku me u rregullu rrugët. Nuk keni parapa as ndriçim publik. Është lëshu ndriçimi publik në pjesën Reshtan-Semetisht dhe ka punu vetëm dy ditë dhe më nuk ka funksionu.

Kryetari - këtu e kam procesverbalin Flamur. Keni kërku rrugën, rruga fillon: Reshtan-Peqan-Semetisht dhe vlera është 430.000,00 €. Keni kërku shtartin e lumit, fillon me u pastru lumi. Keni kërku ndriçim, fillon me ndriçim.

Flamur Bytyçi - Kryetar ti po thua që s'janë këto në dokument por kanë me u bë.

Kryetari - këtu s'janë por është marrëveshja zyrtare e protokoluar me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal. Edhe 150.000,00€ me ia nda fshatit Semetisht, ajo rrugë nuk kryhet. Ajo duhet me fillu në Reshtan e me vazhdu deri mbi Semetisht dhe në të ardhmen me vazhdu në Nishor e Breshancë.

Astrit Salihu - me siguri Kryetari e ka edhe raportin e dëgjimit publik në Mushtisht ku kërkesat e bashkëvendasve tone kanë qenë tri kryesoret. Ka qenë ndriçimi, kanalizimi dhe pastrimi i lumenjëve. Këto problem unë i kam thënë edhe në asamblë. E kam shiku planifikimin dhe sa i përket pastrimit të lumenjëve, është për komunë por në kanalizim dhe në ndriçim nuk pashë asgjë. Kanalizimi është e drejtë themelore e që disa vite në Mushtisht nuk ka investime në këtë drejtim.

Kryetari - vitin e kaluar janë kryer 400 m kanalizim në Mushtisht. Pastrimin e lumit, nuk e di për cilin lum e kërkon. Na kanë blloku në qendër të Mushtishtit, prej urës që shkon për Delloc teposht nuk na kanë lane me pastru lumin.

Astrit Salihu - ndoshta janë punu 400 m por mbi 15 km janë pa përfundu. Pastrimi i lumenjëve, sidomos te lagja e Shaljanëve, aty keni fillu dhe e keni lënë.

Kryetari - 15 km, sivjet i kemi të parapara në gjithë fshatrat. I kemi 42 fshatra.

Nexhat Ramadani - u tha që korniza afatmesme buxhetore është një prej dokumenteve më të rëndësishme që duhet me u përgadit në komunë dhe për këtë janë të parapara afatet ligjore se kur duhet me fillu. Për këtë që po e shohim ne, të gjitha vërejtjet i tha Urimi dhe del që aspak nuk është marrë kush me kornizën. Në një formë është përsëritje e asaj që ka qenë vitin e kaluar. A ka rritje të buxhetit Kryetar dhe sa është buxheti i komunës?

Kryetari - 2 %.

Nexhat Ramadani - sa është në vlerë? Shqetësimi që dua të ngris është se sot nuk i kemi prezentë dy drejtorët që janë përgjegjës për hartimin e këtij projekt-vendimi, Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Drejtoresha e Financave dhe e dime afërsisht pse nuk janë por është çështje tjetër. Shoh që ka rritje te pozicioni i pagave dhe shtesave ndërsa ka ulje te investimet kapitale, pse?

Kryetari - ti e din mirë që korniza kur të vjen prej Prishtinës është e caktuar, është e ndane dhe nuk e rrisim e as nuk e zvogëlojmë ne. Ke qenë vet drejtor.

Nexhat Ramadani - edhe ata kur ta bëjnë ndarjen, ata e japin arsyen pse dhe thonë: ose kanë me u rrit pagat, ose ka m'u bë kjo. Kjo është përgjigja që po e kërkoj Kryetar.

Kryetari - materiali qysh t'ka ardhë ty, më ka ardhë dhe mua.

Kryesuesi - te tabela 4.1 nuk mund të ndërhyhet absolutisht sepse përgaditet nga niveli qëndror.

Nexhat Ramadani - unë bëra vetëm pyetje dhe nuk pata për qëllim provokimin. Nëse ka një parashikim që pagat do të rriten thuhet: për këtë arsye është rrit pozicioni i pagave dhe është zvogëlu pozicioni i investimeve kapitale. Çështja e debateve publike, e tha edhe Flamuri dhe të tjerë. Kur të shohësh njerëz të tillë që janë të papërgjegjshëm, ndonjë ditë s'ka me na ardhë edhe në asamblë sepse çdo shqetësim që ne e ngrisim janë shqetësime serioze. Te lista e investimeve kapitale unë po kthehem te vendbanimi im

dhe është e katërta herë rruga Shadan Gashi të cilën e kam ngrit edhe herën e kaluar.Ndërkohë kjo rrugë e ka ndërru emrin dhe e ka Albanët dhe ju nuk e shkruani si është rruga por e keni shkru Shadan,e herën e kaluar e keni bërë Shaban.Përpos kësaj ajo realisht duhet me qenë edhe në kontratë sepse ka qenë edhe vitin e kaluar.Tri vite është radhazi ndërsa tash e keni planifikuar prap vitin tjetër Asfaltimi.Dy rrugë tjera i keni Bashkim Kabashi-segment në Leshan dhe 2029-tën prap vazhdim segmenti i dytë.Atje ka rrugë të cilat kanë emërtim,të cilat kanë mbi 10 shtëpi,ka banorë shumë aty,ndërsa ju e shkruani degëzim.Degëzim është rrugë për një shtëpi ose dy.E kemi rrugën Kastriotët dhe rrugën Flamurtari në Leshan të cilat kanë mbi 10 shtëpi,kanë banorë dhe nuk shtrihen,ndërsa ju shtroni segmente.Rruga Kastriotët është rruga ku unë e kam pas shtëpinë e vjetër.Tash është vëllau atje dhe unë e kam pjesën tjetër.Edhe për këtë Kryetari ka pas debat edhe me dikënd tjetër që është mik i yni aty dhe ju ka thënë që ky është shkaktari pse kjo rrugë nuk shtrihet.Shkaktar është ky që po flet në asamble.Kështu nuk funksionon Kryetar dhe është e pandershme.Në një fare vakti ka fitu edhe Hitleri dhe Millosheviqi por s'bëhet ashtu arsyetimi.

Kryesuesi - ia tërheq vërejtjen Nexhatit për fjalor joparlamentar dhe i kërkon që ta tërheq fjalën.

Nexhat Ramadani - nëse jeni lëndu, unë ju kërkoj falje.

Laureta Tafaj - këto që do ti adresoj i kam adresu edhe në KPF.Pyetjet janë për Kryetarin ose për Drejtorin e DSHPE.Fshatit Greikoc siç duket ia kemi marrë inatin,nuk e di pse!Edhe Greikoci si krejt të tjerët ka votu për partinë që është në pushtet.Sidomos në lagjen në të cilën jetoj unë,është i teti apo i nënti vit që jam në Kuvend dhe asnjëherë asnjë ndërhyrje,asnjë rregullim,asnjë sanim minimal i rrugës nuk është bërë.Në atë rrugë frekuentohen 80% e nxënësve që shkojnë në shkollë dhe që sa vite kërkojnë ndriçim publik në atë rrugë dhe asnjëherë kurgja nuk ka ndodh.Dikush prej kolegëve të mi e ka premtu që ka me fut në buxhet rrugën "Rrustem Rexha" edhe për shkak që unë jam aty prap nuk ka hy as kësaj here.Kryesues,punoni edhe për neve njëjtë sikur për të tjerët.Në Savrovë e kam pas një shqetësim prej një qytetari ku thotë që rruga "Rifat Halimi" Savrovë ka kontest gjyqësor.Rruga "Livadhet e buta",një pronar i një toke aty iu ka dëmtu ara dhe nuk po mundet me punu për shkak se ka me u bo rruga të cilën e kanë fillu dhe asnjëherë nuk e kanë përfunduar.Ndërtimi i rrugës së UÇK-së degëzim në Savrovë,kjo është e përfunduar.A është një gabim këtu apo çka ka ndodh?Një pyetje për aneksin e shkollës në Njëpërbisht.A do të bëhet ndonjë sallë e sportit apo duhet aneks sepse ka shumë nxënës e duhet me i shtu klasat?Në shëndetësi a janë dëmtu aparaturat apo ka me ardhë diçka e re?

Kryetari - te Savrova është në kornizë në vitin 2029 por vetëm e kanë bërë aneks sepse ajo rrugë e lidh Dubravën dhe Sallagrazhdën dhe ka shumë anekse. Ne vitin e ardhshëm fillojnë me emërtimin e rrugëve sepse ka shumë fshatra që nuk kanë më emër të rrugëve dhe duhet me vazhdu. Te Njëpërbishti bëhet aneks.

Liridon Fandaj -Kryetar pasi i ke procesverbalet, unë kam marrë pjesë në Peqan sepse m'u ka pamundësu me marrë pjesë dikund tjetër për shkak të orarit të njëjtë që i keni mbajtur nëpër gjithë fshatrat. Ne kemi qenë 5 persona dhe kanë qenë disa rekomandime dhe dua ta di a janë ato në buxhet. Unë e kam pa që nuk janë ato sepse e kam mbajtur edhe shënimin dhe nëse thojmë që çka ka pas në procesverbal i kemi fut në buxhet, atëherë kjo nuk qëndron.

Kryesuesi - e hedhë në votim pikën 2.

15 për,12 kundër, Miratohet pik 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen interes i përgjithshëm publik pronat private;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - shpallje të tilla të interesit të përgjithshëm që synojnë rregullimin e infrastrukturës rrugore në aspektin pronësor janë të mirëpritura,qoftë nëse vijnë prej kërkesës së pronarëve privat,qoftë me iniciativë të vet komunës.Prej shqyrtimit të dokumentit që na keni përcjell,prona private në këtë rast është rrugë,pjesë e rrugës Ukë Bytyçi-rruga kryesore e zonës industriale.Është e asfaltuar dhe shfrytëzohet çdo ditë.Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar që ajo pjesë e rrugës e cila është duke u shfrytëzuar t'i këmbëhet në afërsi me një pronë publike.Deri këtu gjithëçka në rregull dhe e mbështesim si propozim.Por nëse i analizon dokumentet më detajisht parashtuesi i kërkesës edhe prej jush në projekt-vendim si pronar i tokës,nuk është pronar i përhershëm por është qiramarrës për 99 vite.Përpara se me vazhdu me votu na duhen disa sqarime prej drejtorive përkatëse.A është vlerësuar nga Drejtoria e Pronës nëse bartësi i një qiramarrje për 99 vite mund të trajtohet në këtë rast në të njëjtën mënyrë si pronar i parcelës?Në projekt-vendim a duhet të specifikohet siç shënon në

qerrifikat të pronës rreth të drejtës së pronësisë dhe jo si pronar i asaj pjese të parcellës. Çfarë statusi juridik do të ketë prona që po shpallet interes i përgjithshëm? A po kompenzohet një e drejtë qiramarrje me një pronë në pronësi të plotë komunale? A është bërë vlerësim profesional që dëshmon se interesi i komunës dhe pasuria publike janë të mbrojtura në këtë rast?

Mensur Selimaj - drejtorja jonë fillimisht e ka pranuar një kërkesë prej biznesit në fjalë dhe e kemi analizuar si kërkesë specifike dhe jemi koordinuar fillimisht me Drejtorinë e Urbanizmit se a kemi të drejtë për me fillu këmbimin e pronës. Drejtori Visar e ka shtjellu lëndën dhe në konsultim me agjencionin, ata kanë rekomanduar që të bëhet këmbimi dhe parcella që e ka biznesin në fjalë është pronar për 99 vite dhe jo qiragji. Këmbimi i pronës së komunës bëhet me aq vite sa e ka në shfrytëzim pronën prej AKP-së. Kjo dallohet prej procedurave tona komunale që i kemi me qera. Kjo është sipas analizës dhe diskutimeve që kemi pas me AKP-në dhe jo zyrtarisht.

Visar Kuçi - sa i përket kërkesës së një qytetare, një biznesi të komunës së Suharekës i cili ka bërë kërkesë te zyra e Kryetarit për parcellën në fjalë, këtij biznesi iu ka marrë prona dhe është ndërtuar asfalti afërsisht në vitin 2012. Biznesi deri para 3 apo 4 muajve nuk ka bërë kërkesë. Me të marrë këtë lëndë, këtu jemi implikuar 4 drejtorë. Drejtorja e Pronës, Drejtorja e Shërbimeve Publike, Drejtorja e Financave dhe Drejtorja e Urbanizmit. Pas shqyrtimit të lëndës nga ana e drejtorive jemi pajtuar me kërkesën e parashtruesit dhe i kemi inicuar procedurat. Fillimisht rruga Ukë Bytyçi është edhe në plan zhvillimor edhe në HZK dhe me planin rregullues në të kaluarën në Zonë Industriale ka qenë e planifikuar rrugë, ku ju ka marrë sipërfaqja. Nëse pronari veq vendos se faktikisht është e tij prona dhe asnjëherë nuk e ka dhënë asnjë nënshkrim, asnjë deklaratë që ka lejuar me ndërtuar atë asfalt qysh në vitin 2012, sot i bie në vijë të bardhë të asfaltit dhe mesin e rrugës duhet me ndalu. Atëherë është në interesin e komunës që të këmbëhet prona dhe kemi prone në afërsi të asaj prone dhe i këmbëhet. I kemi kontaktuar edhe AKP-së dhe AKP-ja na ka sqaruar që prona është e tij, ju e keni të drejtën e këmbimit dhe na ka dhënë edhe disa raste të tjera të shpronësimit. Ne sot jemi duke e shpallur interes.

Deri sa është rrugë AKP-ja i trajton me status të veçantë dhe nëse nuk gabojmë këto ku i trajton me status të veçantë që janë rrugë të planifikuara ose investime, heq dorë edhe pas asaj periudhe. Për çdo gjë komisioni qeveritar kur ta vlerëson, na sqaron dhe e bje lëndën e kompletuar.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ju thotë që është pronar në bazë të diskutimit me AKP-në mirëpo unë po bazohem në dokumentet që ju vet na keni përcjellë e që është një dokument zyrtar tjetër prej Drejtorisë së pronës, që është certifikata e pronës dhe thotë që të drejtat pronësore është qiramarrje për 99 vite. A ka me u bë këmbim siq e keni specifikuar në vendim me biznesin apo me AKP-në? Për arsye se në projekt-vendim po shënon që me pronarin, por këndej kur po thuhet pronari po përmendet BenCenter e pronari i përhershëm është AKP-ja. Të paktën të specifikohet ashtu siç është në certifikatë të pronës që është qiramarrje për 99 vite.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë që çështja e hartimit të kontratave është e rregulluar me rregulloren 03/2013 mbi të drejtat e transferimit të së drejtës së përdorimit të pronës së patundshme në pronësinë shoqërore. Pronësinë shoqërore e ka menaxhuar dhe i menaxhon AKP-ja. Në momentin kur është bërë privatizimi i këtyre pronave, të drejtat mbi këto prona kanë kaluar mbi qiramarrjesin. Qiramarrësi i të drejtës së tillë ka të drejtë të posedojë, tjetërsoj, bartë te personat e tretë dhe të ngarkojë pasurinë subjekt i qerasë si dhe kjo e drejtë mund të trashëgohet. Ka të drejtën edhe të shpronësimit aty ku është interesi publik në këtë rast. Në këtë rast ne nuk kemi të bëjmë fare me AKP-në për arsye se kjo prone shitur nga agjencioni dhe është blerë nga subjekti në fjalë dhe ai ka këto të drejta mbi bazën e kontratës që i ka të rregulluara me AKP-në.

Sanie Kuçi Rexhepaj - në momentin që kjo pronë del në emër të komunës, çfarë statusi e merr?

Avni Bytyqi - e përmendi Drejtori i Pronës dhe tha që e merr statusin e qiramarrjes për 99 vite siq e ka në kontratë. Njëri prej kritereve për fillimin e procedurës së këmbimit është vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm. Në këtë rast komuna do të plotësojë edhe 8 kritere pas këtij kriteri dhe do të shkojë në ministrimin, të bëhet vlerësimi dhe atëherë vjen procedura në këtë kuvend dhe merret vendimi përfundimtar për këmbimin e pronës publike me pronën private.

Sanie Kuçi Rexhepaj - ne veq e thamë që në këtë fazë të parë e mbështesim si propozim por patëm nevojë për sqarime. Në momentin që prona këmbëhet, në këtë rast komuna po bëhet qiramarrëse për 99 vite dhe ai bëhet pronar faktik, a po mbrohet interesi i komunës në këtë rast.

Visar Kuçi - në raste kur ka rrugë ose objekte të investuara, AKP-ja heq dorë prej këtyre rasteve dhe prona i kalon 100% komunës. Dje kam biseduar me AKP-në. Drejtori tutje jep sqarime.

Kryesuesi - e hedhë në votim pikën 3.

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën, hap debatin dhe kërkon propozimet për anëtarë të komisionit.

Sanie Kuçi Rexhepaj - në mandatin e kaluar por edhe këtë mandat në KPF e kam shpreh si shqetësim metodën e mënyrës së votimit së inicimit të procedurave dhe të formimit të komisionit. Ne para dy muajsh e kemi inicuar si procedurë për konkurim të hapur por tek pas dy muajsh po e formojmë komisionin. Kam propozu edhe atëherë dhe propozoj edhe sot. Nuk më duket diçka jo ligjore që brenda përbrenda një seance edhe me fillu inicimi edhe me u formu komisioni. Për mos me humb dy muaj kohë më duken shumë të paarsyeshme.

Kryesuesi - zakonisht e presim ligjshmërinë e vendimit.

Sanie Kuçi Rexhepaj - me provu një herë nuk është fundi i botës sepse ka shumë vendime që janë kthyer mbrapa dhe nuk i keni marrë tragjike. Një propozim i tillë nëse kalon, kursen kohë në shumë procedura.

Aziz Bytyqi - në emër të grupit propozoj Edon Sadikaj.

Urim Suka - ne e kemi diskutu edhe më herët temën për çmimin fillestar dhe është mirë edhe në projekt-vendim me qenë që të bëhet një lloj vlerësimi për çmimin fillestar. Ne propozojmë Astrit Salihun.

Dardan Berisha - PDK propozon Jehona Rrafshin.

Liridon Fandaj - LVV nuk ka propozim.

Kryesuesi - e hedhë në votim propozimin për Edon Sadikaj.

15 për, 10 apstenime.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Astrit Salihun.

8 për, 17 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Jehona Rrafshin.

14 për, 11 apstenime.

Kryesuesi konstaton që nga radha e asamblesë shkojnë në këtë komision me shumicë të votave Edon Sadikaj dhe Jehona Rrafshi.

Kryetari - nga ekzekutivi propozojmë Mensur Selimaj dhe Visar Kuçi, ndërsa nga shoqëria civile Saranda Bajraktari.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Edon Sadikaj, Jehona Rrafshi, Mensur Selimaj, Visar Kuçi dhe Saranda Bajraktari.

15 për, 8 kundër, 4 apstenime, Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e vlerës së bonus banimit;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Flamur Bytyçi - në vitin e kaluar sa ka qenë vlera që i keni nda? A është shpenzu komplet ajo vlerë apo nuk ka pas aq shumë familje që kanë pas nevojë me u mbështet?

Avni Bytyqi - ligji tashmë ka ndryshu për financimin e komunave për banime të veçanta i cili ka parapa çështjen e bonus banimit dhe në atë ligj nuk e ka specifiku që komuna ka për obligim ta specifikojë vlerën financiare sa ka me subvencionu qeranë dhe sipas raportit që e solli zyrtari përgjegjës, vitin e kaluar paska qenë totali 20,610.00€ që janë subvencionu 12 familje. Ndërsa me ligjin e ri që është ndryshu i cili ka hy në fuqi në maj të këtij viti, kërkohet që edhe vlera e planifikuar e subvencionimit të përfshihet në vendim. Ne për vitin 2026 planifikojmë që 25,000.00€ të subvencionojmë 15 familje për qeranë e bonus banimit.

Sanie Kuçi Rexhepaj - komuna jonë nuk ka program të veçantë të banimit në fuqi. E kemi pas një më herët sepse kohëzgjatja është tre vite e një plani të tillë. Dua të di a janë në procedurë të hartimit të planit të ri të programit të veçantë të banimit? Ne çdo vit po marrim vendime të tilla dhe shumë mirë që po marrim por edhe programi i veçantë i banimit është më se i nevojshëm në të tilla raste për shkak se nuk është vetëm kjo metodë e ndihmesës ndaj kategorive që janë të specifikuara në projekt-vendim.

Kryetari - e kemi pa të arsyeshme edhe 5,000.00€ m' i shtu. Ne i kemi në projekt duke i ndërtu 20 shtëpi dhe ende s' kemi ardhë në përfundim. Ka pak numër që kërkojnë me ndërtu shtëpi. Ndoshta kemi nevojë për familjet skamnore që s' kanë ku rrinë por edhe kjo është një shumë simbolike.

Besa Kuçi - një vendim i tillë ka vite që kalon në Asamble dhe është shumë mirë. Ajo më e mira do të ishte për këtë kategori që të bëhet në kuadër të ministrisë ku është edhe kompleksi i banimit social. Me

sa di kanë kërku një kërkesë ministria me bo komuna e Suharekës dhe nuk e di a e kanë bërë një të tillë. Do të ishte mirë edhe Drejtoria e shëndetësisë dhe zyrtarët e saj ta bëjnë një kërkesë te Kryetari dhe Kryetari me vazhdu me apliku. Është mirë që është rrit vlera sepse ka nevojë. Në këtë projekt-vendim kërkoj që tek neni 2 pika 2.2 me u fut edhe kategoria e nënave vetushqyese. E di që ka qenë në shpallje por këtu nuk qenka përfshi dhe nëse është ligjore është mirë me u fut.

Avni Bytyqi - ligji i mëhershëm nuk e ka rregullu çështjen e kategorive dhe ky ligj e rregullon çështjen e kategorive që të subvencionohen dhe janë 16 kategori. Në konsultim me Kryetarin kemi ardhë në përfundim që ti subvencionojmë vetëm tri kategori dhe në kuadër të ligjit nuk është e specifikuar nënat vetushqyese mirëpo nuk prejashtohet mundësia nëse nuk plotësohen kushtet dhe kriteret për 15 familje të përfshihen edhe nënat vetushqyese dhe t'ju mundësohet subvencionimi i qerasë. Të kaluarën për viktimat e dhunës në familje nuk ka qenë e rregulluar me ligj por e kemi mundësu sepse e kemi një marrëveshje me strehimoren por kësaj radhe është e rregulluar edhe me ligj.

Antigona Zyba - në emër të grupit të LVV shprehim mbështetjen tonë për këtë projekt-vendim. E konsiderojmë të drejtë, të nevojshme që komuna jonë të ndërmarrë masa për të ndihmuar qytetarët të cilët përballen me vështirësi ekonomike dhe me strehim. Familjet me asistencë sociale, familjet me shumë fëmijë, prindërit vetushqyes dhe viktimat e familjes meritojnë mbështetje institucionale dhe ky hap është një hap i madh. Megjithatë vlerësojmë se numri prej 15 fituesish dhe fondi prej 25,000.00€ nuk është i mjaftueshëm sepse mendojmë që ka nevoja më të mëdha dhe kërkojmë nga ekzekutivi komunal që të shqyrtoj mundësinë e rritjes së fondit dhe të numrit të familjeve që përfitojnë. Gjithëashtu duhet të theksojmë se subvencionimi i qerasë është një masë e përkohshme dhe nuk e zgjedh problemin e strehimit në mënyrë afatgjatë. Fatkeqësisht komuna jonë nuk ka alikuar kur është dashur në programin e qeverisë për banim social dhe si pasojë nuk ka përfituar. Kjo është një çështje që duhet të na shqetësojë të gjithëve sepse familjet në nevojë nuk kanë nevojë vetëm pagesën e qerasë por edhe për zgjidhjen e përhershme të strehimit. Nëse komuna do të kishte aplikuar në këto programe, sot do të kishim mundësi më shumë për ti siguruar banim social për qytetarët tonë. Kërkojmë nga ekzekutivi komunal që në të ardhmën të jetë më aktiv dhe më i përkushtuar për fondet dhe programet që ofron qeveria. Grupi i LVV do ta mbështes këtë projekt.

Urim Suka - sigurisht që e mbështesim si projekt-vendim. Është një mundësi për me ju ndihmu qytetarëve në nevojë dhe ky projekt-vendim ia lehtëson sa do pak pagesën e obligimeve që ata kanë dhe ne do ta mbështesim patjetër. Raportin që e kemi marrë e kemi shumë të vështirë me lexu sot dhe në praktikën e ardhshme është mire që raporti me na ardhë me material. Avniu tha që në ligj janë 16 kategori dhe këta e kanë përcaktuar tri kategori. Nuk e di pse duhet me u fokusu në vetëm te tri kategori dhe a ndodh që me u prejashtu një kategori që ligji ia jep mundësinë kur ne nuk e kemi në vendim. Për bindjen time fillestare mendoj që të gjitha ato kategori që i jep ligji duhet me qenë. Te puna e ndarjes, unë kam fol edhe më herët për këtë dhe nuk e di sa kriteret e rregullojnë këtë çështje sepse p.sh. secili që është përfitues, dikush e ka një kontratë 500.00€ të qerasë, dikush 200.00€ dhe dikush ndoshta përmes kësaj mundet me shfrytëzu dhe me manipuluar, me bo një kontratë me një vlerë më të madhe për me pagu krejt. Nuk e di kriteret a janë të mira me qëllimin që rezultatet finale të familjet që ju ndihmojnë me qenë i drejtë. Komisioni është mire me parapa këtë edhe gjatë implementimit dhe m'i evitu padrejtësitë brenda asaj që kanë mundësi duke u thirr edhe në ligj.

Kryesuesi - e hedhë në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për caktimin e lokacionit dhe dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - kur jemi te kërkesat e KEDS, ti e ke një adresim, peticion të fshatrave Semetisht, Nishor, Bllacë dhe Sllapuzhan për disa investime që po kanë problem me energji elektrike për linjën që shkon për Peqan. Kur të vje te kjo kontrata duhet me i kushtëzu pak edhe ata të KEK-ut që ne po e japim një pronë në shfrytëzim e ai është operator ekonomikë privat dhe në mënyrë ligjore obligohet që shërbimet ndaj çdo qytetari me i ofru. Ne pronën po e japim por nesër ndryshon dhe nuk është KEDS-i por dikush tjetër, çka ndodh me këta? Nëse ne e japim në shfrytëzim për 99 vite, a ka të drejtë ai me dhënë në shfrytëzim këtë prone dhe a mundet me kalu te një operator tjetër? Nëse i japim këto, të paktën me kushtëzu që ajo pjesë me u kthi në investime.

Avni Bytyqi - nëse i referohemi nenit 3 pragrafi 2 dhe që unë iu kam referu edhe ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës, prona nuk e ndërron titullarin dhe qirambajtësi për 99 vite nuk ka të drejtë ta bartë nën qera të personi të tretë, nuk ka të drejtë ta lërë barrë te ndonjë subjekti tjetër dhe komuna e ruan të drejtën me kthi pronën kur ka interes.

Liridon Fandaj - nëse është shoqëri aksionare dhe i shet aksionet, çka ndodh me të?

Avni Bytyqi - i kthehet prona komunës. Asnjëherë prona publike komunale nuk bëhet pronar i dikujt tjetër.

Flamur Bytyqi - kur ti sjellin kërkesat KEDS, a diskutoni me ta që ne kemi nevojë edhe në investime tjera me bo? A kan ndonjë plan të veprimit apo veq kanë vendos ashtu? Dua të di, ju a keni mujt me kontribu diçka në adresimin e kërkesave që i kanë pas banorët e fshatrave?

Kryetari - dy vitete e fundit kanë investu 1.5 milion euro në Suharekë. Janë afër me investu në Mushtisht dhe kanë një projekt tjetër që shkon një tension i lartë, që fillon në Reqan dhe shkon deri në Budakovë. Unë e kam bërë kërkesën për fshatin Qadrak mirëpo tash kërkesat shkojnë direkt në Prishtinë dhe varet ata si i bëjnë marrëveshjet dhe qysh na ndihmojnë. Të njejtin problem e kemi te shtëpia e kultures ku duhet të vendoset trafa. Ajo trafë që është nuk e plotëson dhe duhet të ndahet buxhet të ri, me vendos trafën dhe me punu të gjitha paisjet në shtëpinë e kultures që janë. Ju e dini që trafat që ka vendos komuna në vitin 2009-2013, afërsisht 8 trafa me bashkëfinancim, të gjitha kanë kalu në pronësi të tyre.

Kryesuesi - e hedhë në votim pikën 6.

22 për, Miratohet pika 6

Pika 7. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Suharekës për vitin 2025;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Doruntina Zenelaj - ajo që ja vlen të theksohet është se Kryetari jonë përveq që është i papërmirësueshëm, ai po i rrit edhe gabimet dhe keqmenaxhimet e tij sepse nga raporti i auditimit shihet se janë 13 rekomandime, 7 prej tyre të përsëritura, 5 të reja dhe 1 pjesërisht i përsëritur. Mosklasifikimi i duhur i shpenzimeve të paguara nga vendimet gjyqësore për paga jubilarë duke paguar nga zëra tërësisht tjerë ku rreth 3 milion prej tyre 2 milion janë paguar nga investimet kapitale që nënkupton se është zvogëluar mundësia e investimeve kapitale për 2 milion vetëm për shkak të mosmenaxhimit të mire. Ndryshime të shumta të ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovimin e kuvendit komunal është një çështje që po e përcjell Kryetarin vazhdimisht edhe pse për këtë çështje çdo herë ka pasur rekomandime nga ana e raporteve të auditimit si dhe ka pasur vërejtje të vazhdueshme nga ana jonë si anëtar të kuvendit. Vonesa në pagimin e obligimeve financiare përsëri është çështje që po e përcjell Kryetarin tonë, proces nga ky i cili buxhet i komunës tone është duke humbur sepse paguan interesa dhe gjopa nga vendimet gjyqësore si pasojë e padive të vazhdueshme që na vijnë nga furnitorët dhe krejt në fund humbin qytetarët tanë. Gjithëashtu ende nuk është zgjidhur çështja e identifikimit të saktë të tatim paguesve duke mos e ditur as numrin e identifikimit të saktë të

tyre si dhe duke mos pasur progres në mbledhjen e të hyrave vetanake nga tatimet në pronë. Përkundrazi kjo çështje është përkeqësuar edhe më tepër. Për më tepër këtë problem e rrit edhe më shumë mangësia e shfrytëzimit të pronave ku nuk e dime saktë se cilat prona të komunës po shfrytëzohen dhe nga kush po shfrytëzohen. Por ajo që ka më së shumti rëndësi dhe që për neve është shumë shqetësuese është vet fakti se ky raport i auditimit është i kualifikuar që nënkupton se ka gjetje të cilat kanë efekt të dëmshëm financiar për vlerën prej 3,082,897.00€ nga buxheti i komunës, të ndërlidhura me pagesa nga kategori ekonomike jo adekuate dhe ajo që neve na shqetëson më shumë se për çdo gjetje në këtë raport auditimi Kryetari jonë është pajtuar dhe nuk ka arsyetim për keqpërdorimet apo keqmenaxhimet e bëra nga ana e tij.

Urim Suka - ne sot jemi për me analizu këtë raport për komunën e Suharekës i cili raport tash më është i kualifikuar dhe me sa unë di kualifikimi do ta eliminonte komunën e Suharekës nga granti i performancës dhe kjo do të krijon probleme edhe për buxhetin në të ardhmen sepse do të kemi edhe humbje financiare për shkak të këtij keqklasifikimi. Ne vazhdimisht kur kemi dhënë vërejtje për mënyrën se si kanë qenë vërejtje të një këndi opozitar, mirëpo këto që do ti lexojmë sot nuk janë tonat, janë të raportit, të dikujt të pavarur që ju ka bërë vlerësimin juve dhe çuditërisht janë gjëra të njejtat që i kemi thënë ne edhe këta, dhe tash po vërtetohet. Ajo që mua më shqetëson më së shumti në këtë raport është që keni marrë 13 rekomandime dhe vetëm 5 janë të reja, 7 janë përsëritje të gabimeve nga viti në vit, 1 pjesërisht përsëritje. Kjo do të thotë që ti me vetëdije je duke e shkel ligjin në vazhdimësi.

Një prej gjetjeve është klasifikimi jo adekuat apo keqklasifikim dhe baza kryesore e opinionit të kualifikuar është fjala për mbi 3 milion euro pagesa të vendimeve gjyqësore. Ne e dime që këto janë si pasojë e kontratës kolektive dhe komuna e ka barren pak më të vogël në raport me institucionet sepse kontrata kolektive është nënshkruar me SBASHK-ut dhe qeverisë dhe qeveria nuk i ka mbulu ato zotime që i ka marrë atëherë. Mirëpo ne e dime, edhe vet raporti po thotë që si komunë ne mundemi që në fillim me i planifiku këto obligime që dalin nga kontrata kolektive dhe nëse ne i planifikojmë, shpenzimet që bëhen për këtë çështje janë shumë më të vogla sepse nuk ka nevojë me pagu për përmbarues e për procedurat gjyqësore e të tjera. Edhe ministria këtu ju ka rekomandu që këtë çështje ta bisedoni me ministrinë e financave dhe ta fusni në kode buxhetore që mos të ketë nevojë me pas edhe keqklasifikim dhe me i humb pastaj edhe mjetet tjera. Çështje tjetër që është e rëndësishme është tejkalimi i afateve të parapara ligjore si ushtrues detyre. Unë vet këtu kam kritiku për këta drejtorat që janë ushtrues detyre për pjesën ku e keni shkel ligjin. Puna e ushtruesve të detyrës duhet me qenë një fazë tepër e shkurtë kalimtare deri sa të zgjidhet drejtori paraprak dhe nuk mund të tejkalohet kaq gjatë sepse ky është dëm i madh që i bëhet shkollave. Gjetje tjetër është ndryshime në shumat e ndara buxhetore në projektet kapitale pa aprovim të kuvendit komunal. Ne e kemi thënë këtë me ngulm vazhdimisht. Ju po i ndërroni projektet kapitale si po doni vet. Çdo fundvit kam dal këtu dhe në emër të grupit kam kërku që të formohet një komision që del dhe i kqyr këto çështje në teren dhe në asnjë rast nuk keni lënë me u formu komisioni dhe me i pa këto sepse s'keni pas vullnet me ndryshu këtë gjendje por keni dasht me shku ashtu drejt paligjshmërisë dhe tash kemi ardhë në këtë raport të auditorit opinion i kualifikuar. Shpresoj ta kuptoni dhe ta ndryshoni në të ardhmen. Vonesa në pagesën e obligimeve financiare është tipik korruptive. Këtu ka pas vonesa deri në 250 ditë dhe raste të tilla ka plot. Është mire ta kuptoni drejt këtë që e kanë shkru në raport dhe ta ndryshoni për vitin e ardhshëm. Mangësi në raportimin e rregullt për shfrytëzimin e pronës komunale. Është fjala për obligimin që e ka Kryetari i komunës çdo 6 muaj me raportu në asamble për kontratat që lidhen në shfrytëzim të pronës komunale edhe komunës me operatorët ekonomikë. Gati kurrë Kryetari i komunës nuk ka raportu. Ne e kemi thënë vazhdimisht dhe tash po e thotë këtë edhe auditori. Në bazë të gjeturave tonat dhe tash edhe të gjeturave të auditorit ju i keni braktis ligjet dhe po vendosni qysh

po doni vet dhe këtë po e bëni qëllimshëm për faktin që kemi edhe përsëritje. Dua të bëj thirrje që të paktën për vitin e ardhshëm mos të kemi përsëritje të të gjeturave që ju tash i dini që janë shkelje ligjore, ti merrni këto vërejtje parasysh, të provoni me ndryshu për vitin e ardhshëm.

Liridon Fandaj - unë desha ti elaboroj disa gjetje që i ka bërë auditori por këto i thane edhe parafolësit dhe vetëm njërën po e them dhe është injorimi i kësaj asambleje nga Kryetari për vendimet që i ka marrë për bartjen e mjeteve. Sot nuk po na injoron vetëm Kryetari por edhe Drejtori i Financave nuk është në këtë raportim. Nuk e di në cilin dokument më bazik se një raport i auditimit me gjetje të përsëritura e sot nuk merr pjesë një zyrtar që duhet me dal me dhënë sqarime për to! Kryetari tha që s'jam ekonomist dhe e gjet veten. Le të na tregojë Kryetari që mjetet që i ka bartë me vendim të vetin, a e ka shkel ligjin dhe a e ka tejkalu 5% e asaj që i lejohet me ligj?

Sanie Kuçi Rexhepaj - Kryetar më duket shumë je duke u frymëzu prej fotografisë tënde që është atje, ku po shkruan Bali Muharremaj Kryetar i Kuvendit Komunal Suharekë 2018-2021. Më vjen keq ta them por as atëherë nuk ke qenë Kryetar i Kuvendit dhe as tash për shkak se raporti i auditimit po thotë që ke marrë aktvendime mbi bartjen e mjeteve në 11 projekte në vlerë 457,039.00€ e që janë e drejtë ekskluzive e Kuvendit dhe jo e jotja. Kjo nuk është keqklasifikim, kjo nuk është keqmenaxhim, kjo është keqpërdorim i detyrës zyrtare. Kjo është pika më kritike e këtij raporti për shkak se krejt tjerat mendoj që me një menaxhim më të mirëfillt mundesh edhe me i përmirësu veq me pas vullnetin politik.

Kryetari - unë jam përgjegjës dhe jap llogari para institucioneve të RKS-së. Kur kemi ardhë me udhëheq komunën e Suharekës, komuna ka qenë e 28-ta në performance. Në debat kam thënë që kemi me qenë te 5-shi. Çdo vit e treta, e katërta dhe për vitin e kaluar jemi e treta në performancë. Mandatin e parë kemi marrë vendim që t'ia paguajmë shujtën mësuesave dhe arsimtarëve për ti stimuluar. Ajo ka vlejti vetëm 6 muaj sepse ka qenë antiligjore. Pas gjashtë muaj e kemi shpallë tenderin për një kompani transportuese për ta paguar 70% e udhëtimit të arsimtarëve dhe mësuesave, dhe në fund nuk kanë dasht me hip në autobus dhe e kemi ndërpre. Kur e kemi bërë këtë kornizë, disa herë kam kërku që a është mundësia me i zvogëlu investimet kapitale, me lënë një fond të veçantë për pagat që po i marrin por nuk na kanë mundësu. Te raporti është keqklasifikim, nuk është keqmenaxhim. Mjetet që janë marrë vitin e kaluar, për ato mjete nese kemi obligime i kry obligimet dhe përgjigjem para drejtësisë. I kemi pas 19 rekomandime, 11 janë zbatu plotësisht, një pjesërisht dhe 5 i kemi të reja. Çdo vit ka me pas të reja sepse disa rregullohen e disa dalin të reja. Shumë gjatë keni me m'pasë këtu sepse po vendos shumica. Me pas

vendos asambleja komunale moti kisha shku.Urim a ka mundësi me thënë najherë mirë në këtë punë apo kurrë mirë s'ka.Si do çoftë kemi qenë në garë dhe vazhdojmë prapë në garë,s'ka problem.

Urim Suka - Kryetar të demantoj vet Kryesuesi.Sot shumë pika i kam votu për.Raporti t'ka ardhë i kualifikuar.A t'hup granti i performancës a s'të hup?sepse nuk fole.Fole për rekomandime të reja,8 i ke përsëritje e si përmende fare.Përsëritje e gjetjeve të njejta do të thotë që je duke e shkel ligjin me qëllim.Edhe para se me ardhë raporti i auditorit a e din sa vërejtjet i kemi thënë për anashkalimin e vendimeve të asamblesë.Tash e ka konstu edhe auditori.Është mire me na ndëgju,me i përmirësu vërejtjet kur ti themi dhe hiq mos me ardhë puna e me pas probleme me ligjin.

Sanie Kuçi Rexhepaj - Kryetar i komunës je dhe ndoshta je edhe sherbetor që po thua në kuptimin e mire të fjalës por kryetar i kuvendit nuk je. Unë aty e pata shqetësimin dhe shqetësimin e kam si përfaqësuese e qytetarëve.

Besa Kuçi - për me ardhë te 2018-ta ka qenë zorë dhe disa që kanë ardhë e dinë qe sa punë është bë.Nuk ka asgjë të keqe nëse është fotografia,gabimi mund të përmirësohet.Një ndër gjetjet është edhe mos regjistrimi i pasurive jo kapitale.Kryetar,Drejtorja e Shëndetësisë respektivisht QKMF këtë punë e ka jo në rregull.Vazhdimisht kemi dërgu shkresa,kërkesa edhe përmes anës tënde që në komisionet që janë formu,me punu në atë drejtim dhe me i regjistru ato pasuri qysh i don ligji.Po ashtu edhe auditorja e komunës ka gjet vërejtje shumë të mëdhaj në këtë drejtim ku kemi dërgu me shkrim edhe disa rekomandime dhe një plan zbatimi por nuk është bërë asgjë në këtë drejtim.Kryetar kërkoj nga ana jote me marrë një vendim më të shpejt dhe me u përmirësu këto.

Pika 8. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga zyra kombëtare e auditimit;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap deabtin.

Urim Suka - ne çdo herë e bëjmë një plan veprimi por kur vjen implementimi i kemi 8 shkelje të përsëritura.Ju edhe planin e veprimit e bëni për me shkel ligjin dhe kjo që po ndodh s'ka kuptim.Kryetar të lutem mbledhë ekiye dhe fillo me reflektu që vitin tjetër të mos kesh përsëritje se u bëmë gaz.

Kryetari - ky është plani i veprimit,iu shpërndajmë rekomandimet drejtorave dhe drejtorat punojnë më shumë.Disa i përmirësojnë,disa dalin të reja.Kështu që çdo herë kemi me pas.

Liridon Fandaj - atë që desha ta them,e tha Kryetari.Kryetari i komunës e ka dorëzuar një listë me premtime krejt mjegull ku krejt fajin ia gjuan të tjerëve përpos vetes.Kur auditori e nxjerr që 3 milion euro janë të keqklasifikuara dhe 2.1 milion janë marrë prej projekteve kapitale,çfarë thotë Kryetari me këtë plan? Do t'i sugjerojmë thesarit të alokojë kode adekuate.Tash ne duhte me i kallëzu edhe thesarit,edhe ministrisë që me këtë plan veprimi ne ju korigjojmë juve sepse ne jemi në rregull.Së dyti ekzekutivi ka bërë 11 pagesa në vlerë prej 457,039.00€ duke marrë paratë nga projektet e miratuara dhe duke i dërguar ku të don vet dhe pa pyetur këtë kuvend.Arsyetimi në këtë plan është: na mori paratë kontrata kolektive andaj na munguan mjetet.Kjo është e pafalshme.Ligji nuk lejon anashkalimin e vullnetit të asambleistëve dhe nevojat e qytetarëve për aktvendime të mbyllura në zyre.Së treti,ku është urgjenca e këtij ekzekutivi për rregullimin e sistemit eprokurimi për kontrata afër 1 milion euro,afati lidhet deri më 31 dhjetor 2026.Për ti rregulluar gabimet e tenderëve në Dubravë në kanalizim përsëri afati është deri në fund të vitit.Për të kthyer ligjshmërinë në Drejtorinë e Arsimit ku pozita e rregullt mbahet me ushtrues detyre tash e dy vite.Na thonë që konkursi do të përfundojë në dhjetor të këtij vit.Pse kjo zvarritje?Pse po lidhen këto pozita e kontrata jasht kontrollit të rreptë për muaj të tërë?Së katërti:shihni si i fyen mërgimtarët tonë për dështimin dhe plotësumin e bazës së të dhënave për tatimin në pronë.Në planin e tyre shkruajnë se mbi 50% e popullatës jeton jasht vendit dhe ka vështirësi që të kontaktohen dhe të mirren ato.Nëse prona është aty,regjistrimin mundet me shku me bo edhe nëse s'është aty personi adekuat dhe nëse ai ka vërejtje mundet me u anku këtu.Kryetari në fund të këtij plani ka shkruar një paragraf ku thotë se nëse dështojnë këto pika përgjegjësa bie mbi bartësit.Krejt planin e ka bë e në fund asnjë përgjegjësi për vete.

Kryetari - regjistrimi i pronave është bë por pa letërnjoftima nuk mundemi me i fut në sistem.

Liridon Fandaj - Kryetar është dasht me vendos një njoftim sepse ka njerëz që kanë paguar shumë dhe kur ka hy në sistem një vlerë e madhe e tatimit ju ka ra tash shumë pak.

Kryetari - tatimi në pronë vjen prej Prishtinës,i kanë kartelat e veta.Ne vetëm e kemi një marrëveshje me postën dhe i shpërndajmë.Disa ankesa i kemi bërë sepse i ka ardhë dikujt më shumë e dikujt më pak por gabimi është në sistem lartë.

Pika 9.Pyetje dhe përgjigje;

Flamur Bytyçi - marrëveshjen e mirëkuptimit që ma dhe për rrugën që lidh fshatrat Reshtan-Semetisht-Nishor,unë të përgëzoj për secilën marrëveshje që lidhet në të mirën e qytetarëve mirëpo nuk e di sa e ke kuptu shqetësimin që unë e dhashë.Prej kësaj marrëveshje ty të obligon një pjesë që ke me pagu edhe vet.Në nenin 5 si komunë obligohesh që në vitin 2027 me i parapa 88,000.00€.Shqetësimi im është ky që pavarësisht që nuk janë të parapara,ti marrëveshjen e ke bërë.Kjo marrëveshje është nënshkruar me 2 qershor,dëgjimet publike në fshatin Semetisht me 20 maj.Andaj ne nuk e kemi ditë që ti e ke bërë një marrëveshje sepse ti marrëveshjen e ke bërë me vonesë.

Kryetari - është një kod i bashkëfinancimit që nuk mundesh me planifiku prej tash për vitin e ardhshëm. Është një kod i bashkëfinancimit dhe me atë kod shkon dhe s'ka problem.

Flamur Bytyçi - si Drejtoreshë që vjen prej botës së artit, unë e kam pa një reagim prej një artisti që ka kërku themelimin e teatrit. Kur ka qeverisë LDK-ja është bërë bujë e madhe themelimin e teatrit. Tash janë bërë gati tre mandate që s'keni nis asnjë procedurë. A keni ndonjë plan për me themelu teatrin?

Donjeta Kabashi - themelimi i teatrit nuk mund të bëhet pa u bërë qertifikimi i shtëpisë së kultures sepse nëse themelohet teatri atëherë duhet të ndahet pagë për krejt. Teatri është duke funksionu, artistat janë duke funksionu, hapësirën e të gjitha kushtet i kanë.

Flamur Bytyçi - e kuptoj por cili është hapi juaj që ju keni me ndërmarrë dhe kur pritet ju me nis si procedurë për teatër. Shqetësimi është edhe i shumë artistëve të respektuar të komunës së Suharekës.

Kryetari - edhe ne i respektojmë. Shumë shpejt bëhemi gati, e sjellim në asamblenë komunale. E kemi dërgu para 4 viteve por atëherë s'ka pas objekt dhe nuk ka kalu.

Vlorë Kryeziu - ndërtimi i zonave infrastrukturore smart duke e ditë se termi smart përfshin ekemente të ndryshme, a mund të na sqaroni më konkretisht se çfarë është paraparë në këtë projekt?

Visar Kuçi - më vjen keq Vlora, jasht e njoftova Flamurin.E din Flamuri dhe ju tregon grupit të LDK-së. Besoj në seancën tjetër ju kthej përgjigje kur të ndodh ajo çka ju ka njoftu Flamuri.

Vlora Kryeziu - interesimi im kryesor mbetet nëse ky projekt do të ndikojë drejtëpërdrejtë në përmirësimin e qasjes dhe sigurisë së qytetarëve duke përfshirë dhe personat me aftësi të kufizuara.

Liridon Fandaj - Kryesues, këto fotografitë që i ke vendos a janë të kryesuesve apo të kryetarëve të komunës.

Kryesuesi - edhe të kryetarëve dhe të kryesuesve.

Liridon Fandaj - atëherë nuk është dasht me i harru edhe të tjerët sepse edhe të tjerë kanë qenë. Ka qenë Haki Gashi herën e parë dhe Refki Gegaj ka qenë kryesues. Mos bëni diskriminim.

Kryesuesi - Këto kanë qenë te salla e vjetër dhe janë bartë këtu por ndërkohë i plotësojmë.

Liridon Fandaj - ka tri seanca që bëj pyetje për qendrën e autizmit Dujë.Nënkryetarja më ka thënë që nuk kanë licencë dhe po vazhdojnë ashtu. Nuk është në rregull Kryetar, me thënë Nënkryetarja që kemi me gjet një mundësi me u taku. Nëse diçka është e paligjshme duhet me u mbyll ose m'u licencu. Cili ka me qenë veprimi yt prej ditës së sotit?

Kryetari - ke plotësisht të drejtë. Presim edhe një muaj nëse e sjell licencën. Është gjynah ata fëmijë me i qu në shtëpi sepse së paku po e kalojnë një kohë aty. Ne disa herë jemi mundu me i ndihmu me subvencione atyre fëmijëve por do të presim edhe një muaj dhe nëse nuk bëhet, e mbyllim.

Liridon Fandaj - Fushëkosova e ka nxjerr një vendim me i ndihmu atyre por nëse ajo nuk është e licencuar edhe në asamble me bërë një kërkesë, nuk mundemi me i ndihmu sepse nuk është e licencuar. Duhet të zgjidhet ajo sepse ka edhe njerëz të vullnetit të mire që duan ti ndihmojnë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - në qershor të viti 2025 në pikat e rendit të dites kemi disku edhe për bonus zonimin.Ka qenë hera e dytë në seancë që ka ardhë me u diskutu ajo pike.Njëherë në maj nuk kaloi,mandej në qershor nuk kaloi,në korrik prap nuk kaloi,në gusht prap u diskutu dhe i mor votat për me kalu.Në tetor u kthy prap si pasojë e një vendimi të ministrisë ku u shfuqizua si rregullore dhe në kohë të fushatës u përdor me propagandë që LDK-ja nuk po i mbështet bizneset dhe pronarët e tokave.Çka është duke bërë komuna tash e një vit në lidhje me bonus zonimin? Duke marrë për bazë që rekomandimi i ministrisë në atë kohë ju ka thënë qartazi që qysh je tu mendu me bërë një rregullore për bonus zonim kur që sa vite nuk keni raportu në kuvend rreth zbatimit të HZK-së dhe PZHK-së. A jeni duke i përgadit raportet rreth zbatimit të HZK-së dhe PZHK-së dhe a jeni duke u marrë me çështjen e bonus zonimit? Pyetja e dytë: porta hyrëse në qytet a ka përfundu si projekt? nëse jo, pse s'ka përfundu dhe në çfarë faze është? Pyetja e tretë: zona industriale në Duhël, ku jeni me procedura?

Visar Kuçi - pyetjet i marrim dhe asamblenë tjetër përgjigjemi.

Kryetari - në fund të korrikut raportohet për dhënien e pronave në shfrytëzim. Raportohet edhe për PZHK-në dhe HZK-në. Sa i përket projektit, nuk e ka kry kompania. Ka pas ngritje të çmimeve për shkak të armatures dhe ka mbet ashtu. Nuk është pranë. Në Biraq është duke u punë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - Drejtori i Urbanizmit nuk ka qenë seancën e kaluar sepse unë të njëjtën pyetje e kam pas edhe atëherë. Tash po don me bojkotu seancën në raportim ndaj qytetarëve që janë duke na ndëgjë dhe e ka për obligim.

Kryesuesi - drejtori nuk tha që nuk do me raportu por seancën tjetër tha që do raportojë.

Astrit Salihu - Kryetar janë bërë tre vite nga vënia e gurëthemelit dhe një vit nga përrurimi i shtëpisë së kulturës Afërdita në Mushtisht dhe desha ta di që kur do të përfundojë? Kur bëhet pranimi teknik?

Kryetari - ka përfundë.

Astrit Salihu - si ka përfundë kur nxemje s'ka? pjesa mbrapa skenës është komplet e parregulluar.

Kryetari - ato që kanë qenë të parapara janë rregullë dhe kur të bëjmë mjete financiare e rregullojmë.

Astrit Salihu - është kërkesë e ardhur nga disa banorë të fshatit Mushtisht. Ambulanta në fshatin tonë në kohë dreke 12 :00deri 13:00e me gjasë është edhe në QMF-të tjera, nuk punon. A është e drejtë kjo Kryetar dhe a ka mundësi me u bë ndonjë zgjidhje për këtë pjesë? Ne jemi të kënaqur me stafin mjekësor por ka pas disa raste kohën e fundit që kanë pas navojë për intervenim mjekësor në atë kohë.

Kryetari - ata ndoshta mund të bëjnë marrëveshje ndërmjet vete por pushimi i drekës është i paraparë prej ores 12:00 deri ora 13:00.

Ilir Voci - kur të del mjeku infermieri nuk mundet me dhënë shërbim pa qenë mjeku sepse me qenë dy mund të bëjnë ndërrime.

Astrit Salihu - megjithatë më mire me qenë një infermier se me qenë e mbyllur.

Urim Suka - unë kur dola fola për problemin e ujës-jellësit për fshatin Duhël dhe ndërkohë ti u përgjigje që e keni bërë një marrëveshje për fshatin Duhël dhe pastaj ma le marrëveshjen me idenë që ju e keni marrëveshjen për Duhël dhe keni fakte. Këtu askund nuk figuron fshati Duhël. Këtu po shkruan për rehabilitim të ujës-jellësit në Suharekë, në Sllapuzhan, në Nishor. Hyna shikova kornizën por në kornizë ke mjete të planifikuar për Maqitevë 35,000.00€ dhe për Delloc 45,000.00€ dhe nuk ka për Sllapuzhan, as për Nishor, as për Suharekë mbi bazën çka pashë unë.

Besoj deri tani keni arrit me lidh një kontratë për mirëmbajtje dhe kanalizime. Unë i kam ngrit shqetësime për problemet në Bllacë dhe ju atëherë keni thënë që si ta bëjmë kontratën kena me i zgjidh. Gjendja është bërë e padurueshme dhe unë po pres me i zgjidh ju ato. Kontrata për mirëmbajtjen e rrugëve ka fillu dikund. Ju lus të shkoni edhe në Duhël, edhe te rrethi dhe te rruga që lidh Bllacën me Duhël sepse problemet janë me vite aty. Drejtoresha e Shëndetësisë nuk qenka këtu. Kam marrë shumë shqetësime që furnizimi me barna është në gjendje kritike. Cila është gjendja me furnizimin me barna, me mjete përcjellëse nëpër AMF, QMF? Më herët kam bërë pyetje për QMF-në në Duhël, aty s'ka pas ujë. Kanë thënë që në korrik do të zgjidhet. A është zgjidhja ndokund apo jo? Dhe pjesa e rrugës që shkon deri në ambulant a ka me u zgjidh apo jo?

Kryetari - the që s'ka buxhet por e ke buxhetin te bashkëfinancimi ku e kemi bërë bartjen e 300,000.00€ mjete me shtesa. E di që nuk është i kënaqshëm furnizimi me barna por ka mjaftueshem por për këtë pyetje duhet ta pyesim Drejtoreshën e Shëndetësisë.

Urim Suka - ju thatë që te bashkëfinancimi kemi me marrë mjete, për çfarë e pate fjalën?

Kryetari - për ujë.

Urim Suka - me sa e di te bashkëfinancimi është kodi te Drejtoria e Bujqësisë. Pra fermerët mos të presin asgjë sepse s'ka asgjë. Ne këtu kemi diskutu me Nënkryetaren ku ato projektet me bashkëfinancim keni me i qu për rrugë. Çka don me mbulu krejt aty te bashkëfinancimi?

Kryetari - ato çka janë.